



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

RAPORTI PUNËS (Janar – Dhjetor, 2023)

- Në seancën e Kuvendit të Komunës të datës 10 mars 2023 është miratuar Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025, ndërsa, me 23 mars 2023, MAPL e ka aprovuar vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e SZHEL 2023-2025.
- Projekti *“Subvencionimi i kapaciteteve prodhuese të NMVM-ve”* – Qëllimi i këtij projekti ka qenë përkrahja e bizneseve që kombinojnë njohuritë, kapacitetet, aftësitë dhe resurset për të zhvilluar konceptin e prodhimit brenda ndërmarrjes, për të stimuluar përmirësimin e proceseve, prodhimin dhe përpunimin e produkteve të reja, qasjen në financa, si dhe rritjen e potencialit për eksport që nënkupton subvencionimin e bizneseve prodhuese, përkatësisht subvencionimi për bizneset të cilat investojnë në blerjen e makinerive prodhuese. Në kuadër të këtij projekti janë mbështetur 16 biznese, prej tyre 10 biznese në pronësi të meshkujve dhe 6 biznese në pronësi të femrave me mbulimin e 30% të vlerës së investuar në blerjen e makinerive prodhuese. Vlera totale e bizneseve që janë mbështetur në pronësi të meshkujve është 40,186.38€, ndërsa në pronësi të femrave 21,825.00 €.
- Projekti *“Ndërtimi i shtigjeve të ecjës në fshatrat Shakovicë-Bellopojë dhe Pakashticë e Poshtme – Zakut”* – Qëllimi i këtij projekti ka qenë ngritja e hapësirave për ecje dhe rekreacion me qëllim të promovimit të karakteristikave dhe potencialeve të këtyre zonave. Projekti ka përfshirë ndërtimin e shtigjeve të ecjes në fshatrat Shakovicë-Bellopojë me gjatësi 6,500 metra dhe Pakashticë e Poshtme - Zakut 3,411 metra, poashtu janë vendosur ulëse për pushim dhe shporta për mbeturina, vlera totale e projektit 248,876.34€.

- Projekti *“Mbështetja me bimë mjaltëdhënëse”* - Qëllimi i projekti ka qenë ngritja e vetëdijës së qytetarëve të Podujevës në mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përmes aktiviteteve bujqësore. Poashtu, fokus i projektit ka qenë edhe mbështetja e fermerëve të vegjël të angazhuar në sektorin e bletarisë. Projekti ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit me organizatën joqeveritare EcoKosWomen –EKW. Në kuadër të këtij projekti janë furnizuar 5 përfitues me fidane të Shërbelës dhe farë të Facelias me qëllim të rritjes së prodhimit të mjaltës, prej tyre tri femra dhe dy meshkuj.
- Projekti PPP *“Parkingun nëntokësor”* -janë zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme dhe është bërë shpallja publike.
- Është angazhuar kompani profesionale për përgaditjen e projekteve lidhur me thirrjen e MBPZHR-së *“Programi për Zhvillim Rural – Grante 2023”*, janë mbështetur me asistencë në përgaditjen e projekteve - aplikimeve gjithësej 17 fermerë.
Vlera totale e projekteve të aplikuar arrin shifrën 1,100.000€.
- Projekti *“Platforma elektronike dhe harta digjitale”* - Është bërë përditësimi i katalogut dhe hartës digjitale – platformës online të parcelave komunale për dhënie në shfrytëzim.
- Projekti i furnizimit me 100 mjete/pajisje pune për biznese start-up dhe ekzistuese. (Rrobaqepësi, Automekanikë, Hekrari etj), është në procedura të prokurimit publik (*ankesa në OSHP*).
- Janë mbajtur sesione informuese dhe asistencë për qytetarë/biznese lidhur me aplikimet në skemat e granteve të publikuara nga MZHR, MINT, MBPZHR etj.
- Janë lëshuar 24 çertifikata të stazhit të punës sipas kërkesave të parashtruara të palëve pranë drejtorisë.
- Projekti *“Zona Industriale”* janë mbajtur dëgjime publike dhe takime në ministri relevante dhe janë siguruar shumica e pëlqimeve-lejeve për funksionalizimin e Zonës, është bërë shpronësimi i pronës/hapsirës ku do të ndërtohet Zona Industriale dhe jemi në finalizimin e të gjithë procesit.
- Është themeluar Ndërmarrja publike *“Eko Llapi”* për të ofruar shërbime publike më të mira dhe me kosto më të ulët dhe tani është i hapur konkursi për antarë të bordit të drejtorëve të ndërmarrjes.

- Raportimi në SEMPK – me Grupin Komunal për Raportim në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Performancës Komunale (SEMPK), kemi udhëhequr procesin e raportimit për vitin 2022.
- Projekti *“Mbështetje me serra 100m², Kultivator me frezë dhe Kultivator me kosë”* - Qëllimi i këtij projekti ka qenë përkrahja e familjeve të komunës së Podujevës në zonat rurale - bujqësi. Projekti është realizuar në bashkëpunim me Islamic Relief Kosova (IRK) ku janë mbështetur 50 fermerë me kultivator me frezë, prej tyre 5 gra fermere dhe 45 fermerë. Ndërsa, 23 fermerë tjerë janë mbështetur me kultivator me kosë. Prej tyre, 5 gra fermere dhe 18 fermerë. Mbështjetja e fermerëve të cilët kanë aplikuar për serra vazhdon në fillim vitin e ardhshëm.
- Është përgaditur lista e bizneseve të regjistruara sipas veprimtarisë në Komunën e Podujevës në pronësi të grave nga viti 2000 e tutje. Lista përfshinë bizneset e regjistruara, pasive dhe ato të shuara. Deri tani janë 457 biznese aktive në pronësi të grave, 283 pasive dhe 68 biznese të shuara.
- Është në realizim projekti/festivali dimëror *“Ditët e fundvitit 2023”* përmes vendosjes së shtëpizave të drurit në sheshin *“Sheshi i Dëshmorëve”* dhe është hapur thirrja publike për aplikim për dhënjën e shtëpizave në shfrytëzim.
- Është përgaditur lista me investitorët e huaj në komunën tonë. Janë gjithësej 18 biznese të regjistruara me pronarë të huaj, e të cilët operojnë në Komunën e Podujevës.
- Hartimi i listës së eksportit aktual sipas veprimtarisë, vëllimit dhe qarkullimit – në bashkëpunim me zyrtarët e ATK-së kemi hartuar listën e eksportit aktual të bizneseve të Komunës së Podujevës.
- Jemi në përfundim të hartimit të listës së të gjitha bizneseve të regjistruara në Komunën e Podujevës, duke i ndarë sipas sektorëve.
- Është subvencionuar KRM Pastrimi – Podujevë, në vlerë financiare prej 20,000€.
- Në koordinim me përfaqësues të barnatoreve që operojnë në Komunë është rregulluar orari i kujdestarive për vitin 2024 lidhur me festat zyrtare, të dielave dhe gjatë natës.
- Kemi aplikuar me dy projekte në thirrjen e MZHR-së *“Programi për Zhvillimin Rajonal 2024”*. Projektet me cilat kemi aplikuar janë: *“Tregu i Gjellbër”* dhe *“Ndërtimi i tri tereneve sportive në Sh.F.M.U. “Zahir Pajaziti” Orllan”*. Jemi duke pritur rezultatet.
- Kemi punuar në Raportimin tre mujor të projektit me Austriakët (Projekti i Huamarrjës).

- Kemi përgaditur dhe ofruar materialet në Zyrën e Auditimit në kontrollin (auditimin) e drejtorisë sonë për vitet 2020, 2021 dhe 2022.
- Kemi marrë pjesë në shumë puntori dhe takime, si:
 - ✓ Takim në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Departamentin e Investimeve Strategjike;
 - ✓ Seminar një ditor të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe OSBE. Tema e seminarit ka qenë: Prezantimi dhe rishikimi i Metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve.
 - ✓ Trajnim për njoftimin e Ndihmës Shtetërore përmes SIMNSH-së të organizuar në IKAP;
 - ✓ Trajnimi dy ditor lidhur me temën “Menaxhimi i Performancës” në IKAP.
 - ✓ Puntori rreth Eko-Turizmit (Projekti i ReLOaD2).
 - ✓ Aktiviteti “Qasja miqësore ndaj mjedisit përmes promovimit të eko-turizmit”, organizuar nga SDK dhe mbështetur nga BE dhe zbatohet nga UNDP.
 - ✓ Takim me përfaqësuesit e GIZ-it lidhur me projektin e tyre “Promovimi i ndërmarrësisë” krahas kësaj, kemi plotësuar dy pyetësor të tyre për vendbanimet e Zonës së Gollakut dhe Zonës Gryka e Llapit;
 - ✓ Puntori në MAPL dhe DEMOS rreth Performancës Komunale;
 - ✓ Takim konsultues me MAPL-në në lidhje me raportimin e projekteve të vitit 2021;
 - ✓ Kemi marrë pjesë në puntori “Hartimi dhe përditësimi i Strategjive Komunale të Turizmit” të organizuar nga AKK dhe PPSE;
 - ✓ Takime në MBPZHR, ARBK dhe KIESA.
 - ✓ Etj.

- Sektori i regjistrimit të Bizneseve ka realizuar këto punë dhe aktivitete :

| Nr. | Aktiviteti | Nr. i lëndëve |
|---------------|--|---------------|
| 1. | Regjistrime të bizneseve të reja | 294 |
| 2. | Shuarje të bizneseve | 44 |
| 3. | Ndryshime në bizneset ekzistuese | 174 |
| 4. | Ndërrim Çertifikate (logo, duplikat) | 94 |
| 5. | Të tjera (shtypja e informatës, vërtetim që nuk ka biznes) | 212 |
| 6. | Refuzime (me kërkesë të palës) | 5 |
| 7. | Përmisim i të dhënave | - |
| TOTALI | | 823 |

(Të dhënat e paraqitura në tabelë janë prej 01.01.2023 deri më dt.19.12.2023)

19.12.2023

Drejtor i DPZHE:
z. Vigan Salihu

